



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 343/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Centar Demokratske Unije (CDU), nga Prizreni, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të numërimit të votave në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Hidhet e palejuar ankesa e Centar Demokratske Unije (CDU) në Prizren.

Arsyetim

Me datën 10.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga CDU, në të cilën theksohet se për VV 1203B/01R në komunën e Leposaviqit, numri i votave të shënuara në faqen zyrtare të KQZ-së është 7 vota. Në numërimin e votave, pas përfundimit të votimit, në procesverbal janë shënuar 47 vota. E bashkangjitur është kopja e procesverbalit. Për komunën e Zveqanit, në faqen zyrtare të KQZ-së zyrtarisht është publikuar 41 votë, sipas pretendimeve të komisionarëve dhe vëzhguesve të angazhuar nga KQZ-ja. Numri total i votave për komunat Mitrovica Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan ka qenë më shumë se 250 vota për CDU-në, ndërsa në faqen e KQZ-së janë publikuar vetëm 70 vota.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës gjeti se :

ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet e subjektit politik CDU janë të pa lejuara në këtë fazë të procesit zgjedhor ngase ankimimi i rezultatit preliminar “K-Vote” të publikuar në vazhdimësi nga KQZ-ja është i pa ankimueshëm sepse ky rezultat është fleksibil dhe i ndryshueshëm në çdo moment. Prandaj duke u bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 343/2014 më datën 12.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*